



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:193069  
Datë: 22.02.2023  
Numri i dokumentit: 04001918

**PKR.nr. 180/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, sipas Kryetarit të Trupit Gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në lëndën penale ndaj të pandehurit E. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr. 258/22 te dt. 20.09.2022, si dhe Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.258/22 të dt.20.09.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.02.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit E. K. dhe mbrojtësit të tij av. K. P. të caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.02.2023 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

**E. K.** i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr....., të lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i lindur me ....., në ....., me vendbanim në fsh. .... K. J...., i biri i ....dhe nënës ... e gjinisë ....., ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedues i tel.nr. ...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

-Më dt. 14.06.2022 rreth orës 16:00 në B. e J. K. J., posedon arme në shkelje me ligjin për armët nenin 5 par. 1 dhe atë armen një pistoletë ngjyrë të zezë e llojit T-T, në atë mënyrë që pasi i pandehuri shkon në bjeshkën e lartcekur dhe aty nga persona të panjohur merr në posedim një pistoletë me të cilën fotografohet t disa herë dhe e poston në rrjetin social T. T. për t'u hetuar me pas nga Policia e Kosovës,

-me çka ka kryer veprë penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar i të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj , gjykata konform nenit 2, 4 par 1 nën par 1.1 dhe 1.3 , nenit 7, 8, 38, 39 par.1. nën par.1.1 , nenit 40 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44, nenit 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe neni 364 të KPP-së, të pandehurin e:

## **G J Y K O N**

Dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind )euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngritur PP/I.nr. 258/22 te dt. 20.09.2022 ndaj të pandehurit E. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Bashkë me aktakuzën prokuroria i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç mënyrë është njoftuar gjykata për detajet.

Gjykata me dt. 20.02.2023, ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent kanë qenë Prokurorit i Shtetit Ersan Qavolli, i pandehuri E. K. dhe mbrojtësi i tij av. K. P. i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në seancën gjyqësor ku shqyrtua marrëveshja për pranimin e fajësisë, i pandehuri deklaroi se e pranon marrëveshjen e arritur në Prokurori dhe i qëndron prapa asaj marrëveshje dhe pranimit të fajësisë sipas asaj marrëveshje.

Mbrojtësi i pandehurit E. K., av. K. P. ka deklaruar se qëndron pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të lidhur në mes prokurorit të shtetit dhe të mbrojturit të tij.

Prokurori deklaroi se qëndron pranë marrëveshjes së arritur në prokurori, kjo marrëveshje është bërë pasi që pasi që i pandehuri i ka kuptuar pasojat dhe natyrën e kësaj veprë penale e cila i vihet në barrë.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 230 par 20 të KPP-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar, apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë, andaj ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin e lartë cekur, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda  
PKR.nr.180/22, dt. 22.02.2023.**

**Bashkëpunëtoreshë profesionale**  
Selvane Bukleta

**Kryetari i Trupit Gjyqësor**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.